



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur dhe vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në mbrojtjen e depozituesve dhe garantimin e sigurisë së depozitave të vendosura në subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;

Duke vlerësuar kontributin e saj në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin bankar dhe financiar të vendit;

Duke mbështetur përpjekjet e institucionit për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe institucional me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e garantimit të depozitave;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm të Agjencisë me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Autoritetin e Mbikëqytjes Financiare, si dhe me partnerët ndërkombëtarë në funksion të forcimit të rrjetit të sigurisë financiare;

Pasi shqyrtoi raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2025, pasqyrat financiare të audituara, raportin e audituesit të pavarur dhe analizën e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura pranë Kuvendit;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2025 në drejtim të:

Ruajtjes së një pozicioni të qëndrueshëm financiar dhe institucional, të reflektuar në rritjen e aktiveve totale në rreth 77.8 miliardë lekë, forcimin e Fondit të Sigurimit të Depozitave në nivelin 77.7 miliardë lekë dhe administrimin e kujdesshëm të burimeve financiare në përputhje me parimet e sigurisë, likuiditetit dhe eficiencës.

Rritjes së mëtejshme të kapaciteteve financiare të skemës së sigurimit të depozitave, duke garantuar gatishmërinë e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore ndaj depozituesve në rast të materializimit të një ngjarjeje sigurimi.

Kontributit në ruajtjen e besimit të publikut ndaj sistemit financiar në kushtet kur depozitat e sigurueshme në sistemin bankar arritën mbi 1.7 trilionë lekë, ndërsa depozitat e siguruara afro 1 trilion lekë në fund të vitit 2025.

Administrimit të kujdesshëm të Fondit të Sigurimit të Depozitave dhe Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, duke ruajtur balancën ndërmjet sigurisë së investimeve, likuiditetit dhe kthimit financiar.

Avancimit të procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2014/49/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi skemat e garantimit të depozitave, përfshirë përgatitjen e projektligjit të ri “Për sigurimin e depozitave”, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”.

Bashkëpunimit efektiv me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Bankën Botërore dhe Departamentin e Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në kuadër të forcimit të kuadrit institucional dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Forcimit të kapaciteteve operacionale dhe teknologjike të institucionit përmes realizimit të ushtrimeve të simulimit për kompensimin e depozituesve, testimit të procedurave të ndërhyrjes dhe përmirësimit të infrastrukturës teknologjike që mbështet proceset kritike të institucionit.

Adresimit të rekomandimeve të përcaktuara në rezolutën e Kuvendit për vitin 2024, veçanërisht në drejtim të harmonizimit ligjor, forcimit të kapaciteteve profesionale, zhvillimit institucional dhe përmirësimit të koordinimit me institucionet e tjera të rrjetit të sigurisë financiare.

Vijimit të aktiviteteve të edukimit financiar dhe ndërgjegjësimit publik për funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave, me synim rritjen e njohurive të qytetarëve për të drejtat dhe garancitë që ofron kjo skemë.

Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2026 të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të përshpejtojë procesin e harmonizimit të plotë të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2014/49/BE dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e garantimit të depozitave, duke mbështetur miratimin dhe zbatimin e kuadrit të ri ligjor në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.

2. Të vijojë analizat teknike dhe financiare për afrimin gradual të nivelit të mbulimit të depozitave me standardet evropiane, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare të skemës.

3. Të forcojë më tej kapacitetet operacionale, procedurat e menaxhimit të krizave dhe planet e vazhdimësisë së veprimtarisë, në funksion të reagimit të shpejtë dhe efektiv në rastet e ndërhyrjes ose kompensimit të depozituesve.

4. Të intensifikojë investimet në modernizimin e infrastrukturës teknologjike, sigurinë kibernetike dhe sistemet e përpunimit të të dhënave në përputhje me standardet më të avancuara ndërkombëtare.

5. Të zhvillojë më tej programet e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimit publik nëpërmjet përdorimit të mjeteve moderne të komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore, mediat dhe grupet e interesit.

6. Të forcojë koordinimin institucional me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe institucionet e tjera të rrjetit të sigurisë financiare, në funksion të rritjes së efektivitetit të mekanizmave të parandalimit dhe menaxhimit të krizave.

7. Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në koordinim me Bankën e Shqipërisë dhe nën udhëheqjen e saj, të ndjekë dhe të vlerësojë zhvillimet institucionale, rregullatore dhe prudenciale që lidhen me Bankën Shqiptare të Zhvillimit, me qëllim vlerësimin e mundësisë së përfshirjes së saj në skemën e sigurimit të depozitave, në rast se veprimtaria e këtij institucioni

hyn në kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për sigurimin e depozitave në Republikën e Shqipërisë.

8. Të vijojë zhvillimin profesional të burimeve njerëzore përmes programeve të specializuara të trajnimit, certifikimit profesional dhe shkëmbimit të praktikave me institucionet homologe ndërkombëtare.

9. Të përmirësojë më tej mekanizmat e kontrollit të brendshëm, auditimit, menaxhimit të riskut dhe raportimit institucional, me synim rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe eficiencës operacionale.

10. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

Miraturar në datën 30.6.2026